

METODOLOGJIA e VLERAVE REFERUESE NË RAST SE TË DHËNAT E MATJES JANË PËRKOHËSISHT TË PADISPONUESHME DHE TË PAARRITËSHME

1. “Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar, matësi është jashtë kushtit teknik apo mungon aksesit në të dhënat e matjes), faturimi i energjisë elektrike do të bëhet me vlerë referuese. Kjo vlerë do të përlogaritet bazuar në mesataren aritmetike të faturimeve me matje përgjatë 3 viteve të mëparshme, të të njëjtit muaj me atë të faturuar. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.”
 - a “Për kontratat e furnizimit me energji elektrike që nuk kanë faturime të viteve të mëparshme të konsumit me matje të energjisë elektrike, faturimi me vlera referuese të bëhet bazuar në mesataren e konsumit me matje të energjisë elektrike, të rregjistruar gjatë vitit të fundit në sistemin e faturimit.
 - b Për kontratat e furnizimit me energji elektrike me mates të energjisë elektrike të instaluar në boks kolektiv, përjashtohet faturimi i energjisë elektrike me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes.”
 - ç. “Për faturimet me vlerë referuese si pasojë e mungesës së aksesit në të dhënat e matjes, në momentin e leximit të të dhënave të matjes, Furnizuesi do të axhustojë në faturën pasardhëse të energjisë elektrike, diferencën ndërmjet sasisë së energjisë së faturuar me vlerë referuese dhe sasisë së energjisë së konsumuar referuar të dhënave të matjes.”.